



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV

Kryesia e Kuvendit

P-114

Prishtinë, më 17 qershor 2013, në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla C-301

PROCESVERBAL

I MBLEDHJES SË KRYESISË SË KUVENDIT, E MBAJTUR MË 17 QERSHOR 2013

Në mbledhje morën pjesë: Jakup Krasniqi, kryetar i Kuvendit, Sabri Hamiti, Petar Miletqi dhe Rasim Demiri, nënkryetarë të Kuvendit.

Nga grupet parlamentare: Adem Grabovci, Ismet Beqiri, Visar Ymeri, Ardian Gjini, Myzejene Selmani, Sasha Milosavleviq dhe Goran Marinkoviq.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

Nga Kabineti i kryetarit të Kuvendit: Eshref Vishi dhe Skender Reçica.

Nga Administrata e Kuvendit: Ismet Krasniqi, Sali Rexhepi, Shefki Shoshaj dhe Sherif Konjufca;

Nga OSBE-ja: Floriana Shala.

Mbledhjen e kryesoi **Jakup KRASNIQI**, kryetar i Kuvendit.

Kryetari e hapi mbledhjen dhe i njoftoi të pranishmit me propozimin e rendit të ditës.

Ai propozoi që rendit të ditës t'i shtohen edhe dy pika shtesë.

Kryesia, me propozimin e kryetarit, i zhvilloi punimet me këtë:

Rend dite

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 10 qershor 2013,
2. Përgatitjet për mbledhjen plenare të radhës.

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 10 qershor 2013

Kryesia e miratoi pa vërejtje procesverbalin e mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 10 qershor 2013.

2. Përgatitjet për mbledhjen plenare të radhës

Kryesia, pasi i shqyrtoi përgatitjet e nevojshme për secilën pikë veç e veç, me pëlqimin e kryetarëve të grupeve parlamentare, vendosi që mbledhja plenare e Kuvendit të mbahet të enjten, më 20 qershor 2013, me këtë:

Rend dite

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës,
2. Koha për pyetje parlamentare,
3. Miratimi i procesverbalit të seancës së mëparshme,
4. Votimi i rekomandimeve nga debati parlamentar lidhur me rirregullimin e taksave të sigurimeve të automjeteve të udhëtarëve dhe automjeteve transportuese të mallrave,
5. Shqyrtimi i Projektligjit për ratifikimin e Marrëveshjes së parë ndërkombëtare të parimeve që rregullojnë normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë,
6. Shqyrtimi i raportit vjetor të Radiotelevizionit të Kosovës për vitin 2012,
7. Shqyrtimi i raportit vjetor të Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës për vitin 2012,
8. Shqyrtimi i raportit vjetor të punës së Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturor për vitin 2012,
9. Shqyrtimi i kërkesës për transferin e mjeteve nga Ministria e Punëve të Brendshme në Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor.

Pikat shtesë:

1. *Kërkesa për lejimin e udhëtimit zyrtar në Strasburg (Francë), prej datës 24-28 qershor 2013*

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

V E N D I M

I. Lejohet udhëtimi zyrtar i deputetëve të Kuvendit: Hydajet Hyseni, nënkryetar i Komisionit për Punë të Jashtme, dhe Vjosa Osmani, anëtare e Komisionit për Integritet Evropian, si dhe zyrtarja nga Drejtoria për Protokoll dhe Marrëdhënie Ndërkombëtare Merita Drenori, për të marrë pjesë në punimet e Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës, në punimet e Komisionit për Imigracion, Refugjatë dhe Persona të Zhvendosur, punimet e Komisionit për Çështje Politike dhe Demokraci, si dhe në punimet e Komisionit për Çështje Sociale, Shëndetësi dhe Zhvillim të Qëndrueshëm, të cilat do të zhvillohen në Francë.

1. Udhëtimi zyrtar i deputetes Vjosa Osmani dhe i zyrtares për Protokoll, Merita Drenori, do të realizohet prej datës 23-27 qershor 2013.

2. Udhëtimi i deputetit Hydajet Hyseni do të realizohet prej datës 23-29 qershor 2013.

II. Të gjitha shpenzimet e këtij udhëtimi për të lartshënuarit në pikën një (I) të këtij vendimi mbulohen nga buxheti i Kuvendit të Kosovës.

2. Kërkesa për lejimin e udhëtimit zyrtar në Strasburg (Francë), prej datës 30 qershor deri më 2 korrik 2013

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

V E N D I M

I. Lejohet udhëtimi zyrtar i deputetëve të Kuvendit: Lutfi Haziri, kryetar i Komisionit për Integritet Evropian, dhe Hydajet Hyseni, nënkryetar i Komisionit për Punë të Jashtme, si dhe zyrtari nga Drejtoria për Protokoll dhe Marrëdhënie Ndërkombëtare, Snoudon Daci, për të marrë pjesë në seancën e jashtëzakonshme të Komisionit për Punë të Jashtme të Parlamentit Evropian, që do të mbahet në Francë.

1. Udhëtimi zyrtar i deputetit Lutfi Haziri dhe zyrtarit për Protokoll, Snoudon Daci, do të realizohet prej datës 30 qershor deri më 2 korrik 2013.

2. Udhëtimi i deputetit Hydajet Hyseni do të realizohet prej datës 29 qershor deri më 2 korrik 2013.

II. Të gjitha shpenzimet e këtij udhëtimi për të lartshënuarit në pikën një (I) të këtij vendimi mbulohen nga buxheti i Kuvendit të Kosovës.

Kryetari e deklaroi të mbyllur mbledhjen e Kryesisë në orën 11:55 minuta.

Kryetari i Kuvendit

Jakup KRASNIQI

Procesverbalin e hartoi:

